


Pjesëmarrësi në kryengritje - Risto Siliqi (1882-1936)

Kosova, më shumë se nga historianët, ishte dhimbje dhe krenari e krijuesve letrarë. Kosova e këtyre krijimeve letrare është tërësia e tokës shqiptare e mbetur jashtë kufijve politik të shtetit shqiptar, duke u mbështetur në faktografinë historike të këtij trualli.

Më 1943 janë botuar dy vepra të plota për Kosovën, historinë dhe madhësitinë e saj, ajo e Hamit Kokalarit "Kosova, djep i shqiptarizmit" dhe e dr. Vafsi Samim Visokës "Nëna Kosovë", cilësuar si Shqipëri e vërtetë. Titujt e veprave që cituam, poezitë e poemat e krijuesve të tjerë dëshmojnë për krenarinë e të gjithëve me Kosovën e kosovarin, me dashurinë e respektin që kishin këta për këto troje, të robëruara gjatë.

Ishin kohët kur nga intelektualli e krijuesi, e jo vetëm nga ushtaraku, kërkohesh të aktivizohej për ta shpëtuar atdheun, kur ai ishte në rrezik, kur rrezikohesh të zhbëhej. Risto Siliqi herët e kishte parë këtë rrezikim dhe mu herët kishte vepruar kundër tij. Ishte ndjekur nga agjentë turq dhe kishte ikur në Cetinë të Malit të Zi. Ishte hetuar dhe kishte përjetuar atentat nga ata, si dhe dënim me vdekje në mungesë. Kudo që ishte vepronte për të njëjtën çështje. Restoranti "Albania" i të vëllezërve ishte bërë qendër e bisedave, e organizimeve të kryengritjeve, siç ishte rasti me atë të Malësisë së Madhe (1912) apo më 1915 kundër synimeve grabitçare malaziase për marrjen e Shkëdrës. Ai të gjitha këto i kishte shprehur në librin "Pasqyrë e ditëve të përgjakshme". Veç këtij aktiviteti, ai kishte lexuar me pasion poetë kombëtarë dhe të huaj, madje edhe kishte hartuar e krijuar vjersha, ku pasqyrohet edhe në formën tjetër tashti, artistike e ndjenjore, ai aktivitet luftarak, atdhetar.

Kur krijon për çështjen shqiptare dhe trimëritë e saj, ai shtrih gjeografinë tërëshqiptare, sikur nuk dëshiron ta pikëtojë vetëm në një vend a krahinë shqiptare elementin e sakrificës dhe të kombëtarisë. Gjeografia e poezisë politike të tij përfshin Hotin e Traboinin, Grudën e Shkrelin, Elbasanin e Labërinë, Vlorën e Korçën, Gjirokastrën e Beratit, Tepelenën e Delvinën, Prishtinën e tërë Kosovën. Po ashtu, fytyrat që



Risto Siliqi në moshën rinore

mbajnë gjallë këto vjersha deklarative janë njerëz të historisë sonë, si Isa Boletini, Idriz Seferi, Hasan Hysen Budakova, Marash Delia e të tjerë, si dhe asish që e bëjnë anën negative të veprimit, si pashallarët e Turqisë, Xhavitit e Turguti, Mahmut Shefqeti, siç e quan ai Sulltan Mahmutin. Këta i dalin madhështorë apo të kundërtën, kur janë në veprim, siç shihet Turgut Pasha që nisët për në Pejë, por gjenden s'e

durojnë Prel Tuli, që nis luftën, të cilin i del për krafi Mehmet Shpendi e Marash Delia së bashku me djemtë e Shalës e të Mërturit, që trimërojnë në Selcë.

Risto Siliqi de fakto kishte krijuar dy poezi për bëmat e Kosovës: "Mas luftimit në Kosovë" dhe "Mbas luftimit në Dukagjin". Që të dyja njëjtëzohen tematikisht dhe janë mjaft deklarative në shprehje. Është frymëzimi nga heroizmi i kosovarëve kundër zaptuesve turq dhe heroizmave të pashoqe që treguan ata. Përshkrimet janë të thjeshta dhe pothuaj tërë poezinë e kulmojnë fytyrat historike, që këtu bëjnë aktivitetet luftarake, për çka edhe i përjetëson historia.

Isa Begu Buletina,

Bir i ndjerës Kosoveshë,

Mbi halldupa, mbi stërvina

Nget e shklet me shpatë çveshë!

Lufta fillon dhe kushtrimi jepet që nga Kaçaniku, por topi e pushka kërset edhe "Kah Prishtina, kah Peshteri". Edhe pse është pabarazi mes luftarakësh, shqiptarët fitojnë, duke e gjunjëzuar dhe thyer moralisht sulltan Mehmetin. Fundi i vjershës përmbillet me gëzimin e fitoreve, që përshkruhet me stilin e vargut të këngëve legjendare, si "Valle Zanat Shqypëtare/Dalin Sharrit e gëzojnë...".

Edhe pse Risto Siliqi nuk ishte ndonjë poet i përkushtuar dhe i mungonte talenti krijues, ai ia shtoi vullnetin e punën e madhe organizative të luftës çlirimtare edhe vargun, që ishte zëri i brendshëm i asaj sakrifice.

Nuk mund të shqitet nga fytyrat historike, nga faktet historike që e rrethojnë, si hyrjet që u dështoi turqve e të tjerë, andaj poezia i mbetet faktografi e vargëzuar, si dhe një ecuri e thënë shkurt, me një nisje të rëndë luftarake, që ka dialektikën e përmbylljen me fitore e gëzime.

Edhe poema e tij fragmentare "Shkëndijat e zemrës sëshqypëtarit" ishte po e kësaj natyre. Ai nuk kishte bërë ndonjë kërcim kualitativ artistik, por kishte ruajtur sinqeritetin rëfyes të asaj që e kishte parë dhe asaj që e kishte dëshiruar. Synimin e vet jetësor-ruajtjen e trojeve shqiptare-gjithkund e kishte respektuar, edhe si veprim, edhe si deklaram apo edhe si krijim, artistik po e quajmë.

Ky krijues minor, që ka edhe garniturën e të tllëve në letërsinë tonë, sikur ua mban ison krijuesve kulmorë të letërsisë sonë, në mos dëshmojnë historikisht të dhënë teorike të librit, se njeriu ka vetëm një fuqi, përkatësisht vetëm një dhunti, e cila e mban, për të cilën jeton dhe me të cilën dëshmon ekzistimin. Të tjerat janë përpjekje për vetëprovokim apo "ndihmesë" tjetrës, që është e përjetshme, e tejkohshme.

Tashti, me vetënjohjen historike dhe kulture tonën, do të kemi mundësi të shohim më drejt shumë gjëra dhe të bëjmë riradhitje të re, por të drejtë dhe të përgjithmonshme të fakteve. •

Sinan GASHI